VENDIM
Nr. 290, datë 13.11.2025

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE AFATGJATA"

Në mbështetje të neneve 16, 20, 23, germa "b", nenit 65, pika 1, dhe nenit 66, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1407/4 prot., datë 24.10.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi miratimin e Rregullores për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata",

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 1752, datë 20.3.2025, të protokolluar pranë ERE-s me nr. 1407, datë 25.3.2025, ka paraqitur kërkesën për miratimin e "Rregullores për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata".

1. Fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a.:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 115, datë 3.6.2025, vendosi "Fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata".

- Draftrregullorja e propozuar nga OST sh.a. përbën transpozim të drejtpërdrejtë të "Rregullores (BE) 2016/1719, 'Për miratimin e udhëzimit për alokimin e kapaciteteve afatgjata'" (e njohur si FCA *Guideline),* në përputhje me vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

2. Konsultimi publik dhe njoftimi i palëve:

- Me shkresën nr. 1407/2 prot., datë 12.6.2025, u njoftuan palët e interesit, si më poshtë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Alpex sh.a., Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), si dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Vendimi nr. 115, datë 3.6.2025, u publikua në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, së bashku me draftrregulloren në gjuhët shqip dhe anglisht, në rubrikën "Konsultime". Gjatë procesit të konsultimit publik, nuk janë paraqitur komente apo përgjigje nga palët e interesit.

3. Vlerësime të ERE-s:

- Në përputhje me nenin 4 të Rregullores (BE) 2016/1719, metodologjitë dhe termat e përbashkëta të zbatueshme nga operatorët e sistemeve të transmetimit miratohen nga autoritetet rregullatore përkatëse, ose, kur është e aplikueshme, nga Bordi Rregullator i Energjisë dhe/ose Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER), në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC. Gjithashtu, rregullatoret përkatës rishikojnë propozimet, pas konsultimit me OST-të, për të siguruar përputhjen me objektivat e rregullores dhe për të garantuar integrimin e tregut, mosdiskriminimin, konkurrencën efektive dhe funksionimin e duhur të tij.

- Duke marrë parasysh sfidat teknike dhe nevojën për ndërtimin e kapaciteteve për pjesëmarrje në mekanizmat rajonalë të ankandeve afatgjata, propozohet që hyrja në fuqi e rregullores të jetë më datë 1 nëntor 2026, për të mundësuar përgatitjen e plotë të strukturave përgjegjëse dhe infrastrukturës teknologjike të nevojshme.

- Në vijim të komenteve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të përcjella nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 24.7.2025, vlerësohet se këto sugjerime kanë rëndësi të veçantë për qasjen e ndjekur nga ERE në transpozimin e Kodit të Rrjetit dhe Udhëzimeve të Tregut, përfshirë rregulloren në fjalë. Komentet theksojnë nevojën që detyrimet që rrjedhin për OST, NEMO dhe autoritetet rregullatore të jenë të përcaktuara qartë në nivelin përkatës ligjor, si dhe të sigurohet koordinim i plotë me dispozitat mbi ACER-in, metodologjitë e përbashkëta (TCMs), çështjet ndërkufitare dhe qendrat rajonale të koordinimit (RCC).

- Për rrjedhojë, ERE do të vijojë të ushtrojë diskrecionin e saj publik në zbatimin dhe interpretimin e këtyre detyrimeve, duke vlerësuar rast pas rasti çdo vendimmarrje që lidhet me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të vendimeve të autoriteteve rregullatore kombëtare (NRAs), ACER-it dhe ECRB-së, në përputhje me legjislacionin sektorial kombëtar dhe detyrimet që rrjedhin nga kuadri i Komunitetit të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Rregullores për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata" (bashkëlidhur).
2. OST sh.a. të raportojë periodikisht çdo tre muaj mbi ecurinë e përgatitjes së metodologjive të përcaktuara në nenet 10–18 të Rregullores.
3. OST sh.a. të depozitojë për shqyrtim metodologjitë përkatëse, sipas afateve të përcaktuara, 6 muaj nga miratimi i TSO-ve.
4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE E KOMISIONIT (BE) 2016/1719, E DATËS 26 SHTATOR 2016,
PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE AFATGJATA

Përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC i datës 15 dhjetor 2022, për përshtatjen e rregullores (BE) 2019/942, rregullores (BE) 2019/943, rregullores (BE) 2015/1222, rregullores (BE)) 2016/1719, rregullores (BE) 2017/2195, rregullores (BE) 2017/2196, rregullores (BE) 2017/1485 të Komunitetit të Energjisë, që ndryshon shtojcën I të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, dhe mbi ndryshimet e vendimeve të Këshillit Ministror nr. 2021/13/MC-EnC dhe nr. 2011/02/MC-EnC.

Neni 1
Lënda dhe qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregulla të detajuara për alokimin e kapacitetit ndërzonal në tregjet në avancë, për krijimin e një metodologjie të përbashkët për të përcaktuar kapacitetin ndërzonal afatgjatë, për krijimin e një platforme të vetme alokimi <...> Ku ofertohen të drejtat e afatgjata të transmetimit dhe mundësinë e kthimit të të drejtave afatgjata të transmetimit për alokimin e mëtejshme të kapacitetit ose transferimin e të drejtave afatgjata të transmetimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

2. Kjo Rregullore do të zbatohet për të gjitha sistemet e transmetimit dhe interkoneksionet në Komunitetin e Energjisë, përveç sistemeve të transmetimit <...>, të cilat nuk janë të lidhura me sistemet e tjera të transmetimit nëpërmjet interkonektorëve.

3. Në Palët Kontraktuese kur ekzistojnë më shumë se një OST, kjo Rregullore do të zbatohet për të gjitha OST-të, brenda asaj Pale Kontraktuese. Kur një OST nuk ka një funksion të lidhur me një ose më shumë detyrime, sipas kësaj rregulloreje, Palët Kontraktuese mund të parashikojnë që përgjegjësia për përmbushjen e këtyre detyrimeve t'i caktohet një ose më shumë OST-ve të tjera.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet në nenin 2 të rregullores (KE) nr. 2019/943. i përshtatur dhe i miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, neni 2 i Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, neni 2 i rregullores së Komisionit (BE) nr. 543/2013, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2015/01/MC-EnC, si dhe neni 2 i direktivës (EU) 2019/944, siç është përshtatur dhe miratuar nga vendimi Këshillit Ministror 2021/12/MC-EnC.

Përveç kësaj, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Alokimi i kapacitetit afatgjatë" nënkupton atribuimin e kapacitetit ndërzonal afatgjatë nëpërmjet një ankandi përpara afatit kohor të ditës në avancë.

2. “E drejtë afatgjatë transmetimi” do të thotë një e drejtë fizike e transmetimit ose një FTR – opsion ose një FTR – detyrim i fituar në alokimin e kapacitetit në afatgjatë.

3. “Rregullat e alokimit” do të thotë rregullat për alokimin e kapacitetit afatgjatë të aplikuar nga platforma e vetme e alokimit.

4. “Platforma rajonale e alokimit” do të thotë platforma e përcaktuar nga neni 48.

5. “Ankand” do të thotë procesi me anë të të cilit kapaciteti ndërzonal afatgjatë u ofrohet dhe u alokohet pjesëmarrësve të tregut që paraqesin oferta.

6. “UIOSI” do të thotë parimi; sipas të cilit vlerat e kapacitetit që u përkasin të drejtave fizike afatgjatë të transmetimit të blera, por të panominuara, do të mundësohen automatikisht për alokimin e kapacitetit për ditën në avancë dhe në këmbim, mbajtësi i këtyre të drejtave të transmetimit fizike do të marrë kompensim nga operatorët e sistemeve të transmetimit.

7. “Nominim” do të thotë njoftimi për përdorimin e kapacitetit afatgjatë ndërzonal nga një mbajtës i të drejtave fizike të transmetimit dhe palës tjetër, ose një palë e tretë e autorizuar, për OST-të përkatëse.

8. “Rregullat e nominimit” do të thotë rregullat në lidhje me njoftimin e përdorimit të kapacitetit ndërzonal afatgjatë nga një mbajtës i të drejtave fizike të transmetimit dhe palës tjetër, ose një palë e tretë e autorizuar, për OST-të përkatëse.

9. “Marzhi i tregut” do të thotë diferenca midis çmimeve për orë të ditës para të dy zonave të ofertimit përkatëse për njësinë kohore përkatëse të tregut në një drejtim specifik.

10. “Rregullat e kompensimit” do të thotë rregullat, sipas të cilave çdo OST përgjegjës për kufirin e zonës së ofertimit, ku janë ndarë të drejtat afatgjata të transmetimit, kompenson mbajtësit e të drejtave të transmetimit për kufizimin e të drejtave afatgjata të transmetimit.

11. “Shtet anëtar” nënkupton një territor të Bashkimit Evropian të përmendur në nenin 27 të Traktatit.

Neni 3

Objektivat e alokimit të kapaciteteve afatgjata

Kjo rregullore synon:

a) promovimin e tregtisë efektive afatgjatë ndërzonale me mundësi mbrojtëse afatgjatë ndërzonale për pjesëmarrësit e tregut;

b) optimizimi i llogaritjes dhe alokimit të kapacitetit ndërzonal afatgjatë;

c) sigurimi i aksesit jodiskriminues në kapacitetin ndërzonal afatgjatë;

d) sigurimin e trajtimit të drejtë dhe jodiskriminues të OST-ve, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, Bordi Rregullator të Komunitetit të Energjisë, autoritetet rregullatore dhe pjesëmarrësit e tregut;

e) duke respektuar nevojën për një alokim të drejtë dhe të rregullt të kapaciteteve afatgjata dhe formim të rregullt të çmimeve;

f) sigurimin dhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së informacionit për alokimin e kapaciteteve afatgjata;

g) të kontribuojë në funksionimin dhe zhvillimin efikas afatgjatë të transmetimit të energjisë elektrike dhe sektorit të energjisë elektrike në Komunitetin e Energjisë.

Neni 4

Miratimi i termave dhe kushteve ose metodologjive

1. Kur kjo rregullore kërkon që OST-të duhet të zhvillojnë termat dhe kushtet ose metodologjitë, ata duhet t'i paraqesin këto akte për miratim te Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, ose autoriteti rregullator kompetent brenda afateve përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore. <...>Kur një propozim për termat dhe kushtet ose metodologjitë në përputhje me këtë rregullore duhet të hartohet dhe të miratohet nga më shumë se një OST, OST-të pjesëmarrëse duhet të bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën. OST-të, me ndihmën e ENTSO-s për Energjinë Elektrike, do të informojnë rregullisht autoritetet rregullatore kompetente dhe Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, në lidhje me ecurinë e zhvillimit të këtyre termave dhe kushteve ose metodologjive.

3. Kur OST-të që vendosin për propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë e listuara në paragrafin 7 nuk arrijnë një marrëveshje dhe kur rajonet në fjalë përbëhen nga më shumë se pesë Palë Kontraktuese dhe/ose Shtetet Anëtare, ato duhet të vendosin me votim të shumicës së cilësuar. Një shumicë e cilësuar për propozimet, në përputhje me paragrafin 7, do të kërkojë shumicën e mëposhtme:

a) OST-të që përfaqësojnë të paktën 72% të Palëve Kontraktuese dhe/ose Shtetet Anëtare të interesuara; dhe

b) OST-të që përfaqësojnë Palët Kontraktuese dhe/ose Shtetet Anëtare, që përbëjnë të paktën 65% të popullsisë së rajonit në fjalë.

Një pakicë bllokuese për vendimet mbi propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë e listuara në paragrafin 7 do të përfshijnë të paktën numrin minimal të OST-ve që përfaqësojnë më shumë se 35% të popullsisë së Palëve Kontraktuese pjesëmarrëse dhe/ose Shtetet Anëtare, plus OST-të që përfaqësojnë të paktën një shtesë Palë Kontraktuese dhe/ose Shteti Anëtar në fjalë, në rast të të cilit shumica e cilësuar do të konsiderohet e arritur. OST-të që vendosin për propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë e renditura në paragrafin 7, në lidhje me rajonet e përbëra nga pesë Palë Kontraktuese dhe/ose Shtetet Anëtare, ose më pak, duhet të vendosin me konsensus.

Për vendimet e OST-së mbi propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë e renditura në paragrafin 7, një votë do të atribuohet për çdo Palë Kontraktuese ose Shtet Anëtar. Nëse ka më shumë se një OST në territorin e një Pale Kontraktuese ose një shtet anëtar, Pala Kontraktuese ose Shteti Anëtar do të ndajë kompetencat e votimit ndërmjet OST-ve

4. Nëse OST-të nuk arrijnë të paraqesin një propozim fillestar ose të ndryshuar për termat dhe kushtet ose metodologjitë tek autoritetet rregullatore kompetente, ose Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, në përputhje me paragrafin 7 ose 11, brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, ata do t'u ofrojnë autoriteteve rregullatore kompetente dhe Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, draftet përkatëse të propozimeve për termat dhe kushtet ose metodologjitë dhe të shpjegojë se çfarë e ka penguar një marrëveshje. Bordi Rregullator i Energjisë dhe, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që vepron në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, ose të gjitha autoritetet rregullatore kompetente së bashku, do të ndërmarrin hapat e duhur për miratimin e termave dhe kushteve ose metodologjive të kërkuara, në përputhje me paragrafët 7, respektivisht, për shembull, duke kërkuar ndryshime ose duke rishikuar dhe plotësuar draftet, sipas këtij paragrafi, duke përfshirë kur nuk janë paraqitur drafte dhe t'i miratojë ato.

5. Çdo autoritet rregullator, ose kur është e aplikueshme, Bordi Rregullator i Energjisë dhe, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që veprojnë në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, sipas rastit, do të jetë përgjegjës për miratimin e termave dhe kushteve, ose metodologjive të përmendura në paragrafët 6 dhe 7. Përpara miratimit të termave dhe kushteve ose metodologjive, Bordi Rregullator i Energjisë dhe, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që veprojnë në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, ose autoritetet rregullatore kompetente do të rishikojnë propozimet, kur është e nevojshme, pas konsultimit me OST-të përkatëse, në mënyrë që të sigurohet që ato janë në përputhje me qëllimin e kësaj rregulloreje dhe të kontribuojnë në integrimin e tregut, mosdiskriminimin, konkurrencën efektive dhe funksionimin e duhur të tregu.

6. OST-të duhet të zbatojnë termat dhe kushtet ose metodologjitë e mëposhtme: çdo ndryshim i tij do t'i nënshtrohet miratimit nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë që vepron në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC:

a) metodologjinë për dërgimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, sipas nenit 17(1) të Rregullores (BE) 2016/1719;

b) metodologjinë e modelit të rrjetit të përbashkët sipas nenit 18(1) të Rregullores (BE) 2016/1719;

c) kërkesat për platformën e vetme të alokimit sipas nenit 49 të rregullores (BE) 2016/1719, që i nënshtrohet nenit 48, paragrafët 4 ose 6 të kësaj Rregulloreje;

d) rregullat e harmonizuara të alokimit në përputhje me nenin 51 të rregullores (BE) 2016/1719;

e) metodologjia e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni, në përputhje me nenin 57 të rregullores (BE) 2016/1719;

f) metodologjia për ndarjen e kostove të krijimit, zhvillimit dhe funksionimit të platformës së vetme të alokimit, në përputhje me nenin 59 të rregullores (BE) 2016/1719, që i nënshtrohet nenit 48, paragrafët 4 ose 6, të kësaj Rregulloreje;

g) metodologjia për ndarjen e kostove të bëra për të siguruar qëndrueshmëri dhe shpërblim të të drejtave afatgjata të transmetimit, në përputhje me nenin 61 të Rregullores (BE) 2016/1719.

7. Propozimet për kushtet e mëposhtme ose metodologjitë dhe çdo ndryshim i tyre do t'i nënshtrohet miratimit nga të gjitha autoritetet rregullatore të rajonit në fjalë:

a) metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit sipas nenit 10;

b) metodologjinë për ndarjen e kapaciteteve ndërzonale, në përputhje me nenin 16;

c) hartimin rajonal të të drejtave afatgjata të transmetimit në përputhje me nenin 31;

d) vendosja e procedurave të kthimit në përputhje me nenin 42;

e) kërkesat rajonale të rregullave të harmonizuara të alokimit në përputhje me nenin 52, duke përfshirë rregullat rajonale të kompensimit në përputhje me nenin 55;

f) kërkesat për platformën rajonale të alokimit në përputhje me nenin 49;

g) metodologjinë për ndarjen e kostove të krijimit, zhvillimit dhe funksionimit të platformës rajonale të alokimit në përputhje me nenin 59.

8. Propozimi për termat dhe kushtet ose metodologjitë duhet të përfshijë një afat kohor të propozuar për zbatimin e tyre dhe një përshkrim të ndikimit të tyre të pritshëm në objektivat e kësaj rregulloreje. Propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë që i nënshtrohen miratimit nga disa ose të gjitha autoritetet rregullatore, në përputhje me paragrafin 7 do t'i dorëzohen Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që veprojnë në përputhje me nenin

2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC brenda 1 jave nga paraqitja e tyre tek autoritetet rregullatore. Me kërkesë të autoriteteve rregullatore kompetente, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që veprojnë në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, do të japë një mendim brenda 3 muajve për propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë.

9. Kur miratimi i termave dhe kushteve, ose metodologjive në përputhje me paragrafin 7 ose ndryshimi, në përputhje me paragrafin 11, kërkon një vendim nga më shumë se një autoritet rregullator, autoritetet rregullatore kompetente do të konsultohen dhe do të bashkëpunojnë ngushtë dhe do të koordinojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të arrijnë një marrëveshje. Kur është e aplikueshme, autoritetet rregullatore kompetente do të marrin parasysh opinionin e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë. Autoritetet rregullatore ose, aty ku është kompetente, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që veprojnë në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, do të marrë vendime në lidhje me termat dhe kushtet ose metodologjitë e paraqitura, në përputhje me paragrafin 7, brenda 6 muajve nga marrja e termave dhe kushteve ose metodologjive nga Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose, kur është e zbatueshme, nga autoriteti i fundit rregullator në fjalë. Afati fillon në ditën pas asaj në të cilën propozimi i është dorëzuar Bordi Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë <...>ose autoritetit të fundit rregullator të interesuar në përputhje me paragrafin 7.

10. Kur autoritetet rregullatore nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një marrëveshje brenda periudhës së përmendur në paragrafin 9, ose me kërkesën e tyre të përbashkët, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë që veprojnë në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, do të miratojë një vendim, në lidhje me propozimet e paraqitura për termat dhe kushtet ose metodologjitë brenda 6 muajve.

11. Në rast se Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose të gjitha autoritetet rregullatore kompetente së bashku kërkojnë një ndryshim për të miratuar termat dhe kushtet ose metodologjitë e paraqitura në përputhje me paragrafin 7, OST-të përkatëse do të paraqesin një propozim për termat dhe kushtet ose metodologjitë e ndryshuara për miratim brenda 2 muajve pas kërkesës nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose autoritetet rregullatore. Te Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë ose autoritetet rregullatore kompetente do të vendosin për termat dhe kushtet e ndryshuara ose metodologjitë, brenda 2 muajve pas dorëzimit të tyre. Kur autoritetet rregullatore kompetente nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një marrëveshje mbi termat dhe kushtet ose metodologjitë, në përputhje me paragrafin 7, brenda afatit 2-mujor, ose me kërkesën e tyre të përbashkët Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, që vepron në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC do të miratojë një vendim, në lidhje me termat dhe kushtet ose metodologjitë e ndryshuara brenda 6 muajve. Nëse OST-të përkatëse nuk dorëzojnë një propozim për termat dhe kushtet ose metodologjitë e ndryshuara, do të zbatohet procedura e parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni.

12. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunim i Rregullatorëve të Energjisë duke vepruar në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, ose autoritetet rregullatore së bashku, kur ato janë përgjegjëse për miratimin e termave dhe kushteve ose metodologjive, në përputhje me paragrafin <...>7, mund të kërkojnë përkatësisht propozime për ndryshimin e këtyre kushteve dhe metodologjive dhe të përcaktojë afatin për dorëzimin e këtyre propozimeve. OST-të përgjegjëse për zhvillimin e një propozimi për termat dhe kushtet ose metodologjitë mund t'u propozojnë ndryshime autoriteteve rregullatore dhe Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë. Propozimet për ndryshimin e termave dhe kushteve ose metodologjive do t'i nënshtrohet konsultimit, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 6 dhe miratohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen.

13. OST-të përgjegjëse për vendosjen e termave dhe të kushteve, ose metodologjive në përputhje me këtë Rregullore duhet t'i publikojnë ato në internet pas miratimit nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, ose autoritetet rregullatore kompetente, ose, nëse nuk kërkohet një miratim i tillë, pas krijimit të tyre, përveç rasteve kur një informacion i tillë konsiderohet konfidencial në përputhje me nenin 7.

Neni 5
Përfshirja e palëve të interesuara

1. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, në bashkëpunim të ngushtë me ENTSO-n për Energjinë Elektrike, do të organizojë përfshirjen e palëve të interesuara, në lidhje me alokimin e kapaciteteve afatgjata dhe aspekte të tjera të zbatimit të kësaj Rregulloreje. Kjo përfshin takime të rregullta me palët e interesuara për të identifikuar problemet dhe për të propozuar përmirësime që lidhen veçanërisht me funksionimin dhe zhvillimin e alokimit të kapaciteteve afatgjata, duke përfshirë harmonizimin e rregullave të ankandit. Kjo nuk do të zëvendësojë konsultimet me palët e interesuara në përputhje me nenin 6.

Neni 6
Konsultimi

1. OST-të përgjegjëse për paraqitjen e propozimeve për termat dhe kushtet ose metodologjitë ose amendimet e tyre, në përputhje me këtë Rregullore do të konsultohen me palët e interesuara, duke përfshirë autoritetet përkatëse të çdo Shteti Anëtar dhe Palë Kontraktuese, mbi projektpropozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë e përcaktuara shprehimisht në këtë rregullore. Konsultimi do të zgjasë për një periudhë jo më pak se një muaj.

2. Propozimet e paraqitura nga OST-të në nivel rajonal do të dorëzohen për konsultim të paktën në nivel rajonal. Palët që paraqesin propozime në nivel dypalësh ose shumëpalësh do të konsultohen të paktën me Shtetet Anëtare dhe Palët Kontraktuese të prekura.

3. Subjektet përgjegjëse për propozimin për termat dhe kushtet ose metodologjitë do të marrin në konsideratë siç duhet pikëpamjet e palëve të interesuara që rezultojnë nga konsultimet e ndërmarra në përputhje me paragrafin 1, përpara paraqitjes së tij për miratim rregullator nëse kërkohet, në përputhje me nenin 4, ose përpara publikimit në të gjitha raste të tjera. Në të gjitha

rastet, një justifikim i qartë dhe i fortë për përfshirjen ose jo të pikëpamjeve që rezultojnë nga konsultimi do të zhvillohet dhe publikohet në kohën e duhur përpara ose njëkohësisht me publikimin e propozimit për termat dhe kushtet ose metodologjitë.

Neni 7
Detyrimet e konfidencialitetit

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar, në përputhje me këtë rregullore, do t'u nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4.
2. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet për çdo person që u nënshtrohet dispozitave të kësaj rregulloreje.
3. Informacioni konfidencial i marrë nga personat e përmendur në paragrafin 2 gjatë kryerjes së detyrave të tyre nuk mund t'i zbulohet asnjë personi ose autoriteti tjetër, pa paragjykuar rastet e mbuluara nga legjislacioni kombëtar, dispozitat e tjera të kësaj rregulloreje ose legjislacion tjetër përkatës kombëtare ose të Komunitetit të Energjisë.
4. Pa paragjykuar rastet e mbuluara nga legjislacioni kombëtar, autoritetet rregullatore, organet ose personat që marrin informacion konfidencial në përputhje me këtë rregullore mund ta përdorin atë vetëm për qëllimin e kryerjes së funksioneve të tyre sipas kësaj rregulloreje.

TITULLI II
KËRKESAT PËR TERMAT, KUSHTET DHE METODOLOGJITË

KAPITULLI 1
LLOGARITJA E KAPACITETIT AFATGJATË

SEKSIONI 1
KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Neni 8
Rajonet e llogaritjes së kapacitetit

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, rajonet e llogaritjes së kapacitetit do të jenë ato të përcaktuara në përputhje me nenin 15 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 9
Kornizat kohore të llogaritjes së kapacitetit

Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit duhet të sigurojnë që kapaciteti ndërzonal afatgjatë të llogaritet për çdo alokim të kapacitetit afatgjatë dhe të paktën në kornizat kohore vjetore dhe mujore.

SEKSIONI 2

Neni 10

Metodologjia e llogaritjes së kapacitetit

1. Jo më vonë se gjashtë muaj pas miratimit të metodologjisë së përbashkët dhe të koordinuar të llogaritjes së kapacitetit të përmendur në nenin 9(7) të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të paraqesin një propozim për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit për kornizën e kohës afatgjate brenda rajonit përkatës. Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me nenin 6.

2. Qasja e përdorur në metodologjinë e përbashkët të llogaritjes së kapacitetit do të jetë ose një qasje e koordinuar e kapacitetit neto të transmetimit ose një qasje e bazuar në rrjedhën e energjisë *(flow based)*.

3. Metodologjia e llogaritjes së kapacitetit duhet të jetë në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit të krijuar për afatet kohore të ditës në avancë dhe brenda ditës, në përputhje me nenin 21(1) të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

4. Pasiguria e lidhur me kornizat kohore afatgjata të llogaritjes së kapacitetit do të merret parasysh kur aplikohet:

a) një analizë sigurie e bazuar në skenarë të shumtë dhe duke përdorur inputet e llogaritjes së kapacitetit, qasjen e llogaritjes së kapacitetit të përmendur në nenin 21(1)(b) dhe vërtetimin e kapacitetit ndërzonal të përmendur në nenin 21(1)(c) të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC; ose

b) një qasje statistikore e bazuar në kapacitetin historik ndërzonal për kornizat kohore të ditës në avancë, ose brenda ditës, nëse mund të demonstrohet se kjo qasje mund:

i. rrisë efikasitetin e metodologjisë së llogaritjes së kapacitetit;

ii. marrë më mirë parasysh pasiguritë në llogaritjen afatgjatë të kapacitetit ndërzonal, sesa analiza e sigurisë në përputhje me paragrafin 4(a);

iii. rrisë efikasitetin ekonomik me të njëjtin nivel sigurie të sistemit.

5. Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit mund të aplikojnë së bashku qasjen e bazuar në rrjedhën *(flow based)* për kornizat kohore të llogaritjes së kapacitetit afatgjatë në kushtet e mëposhtme:

a) qasja e bazuar në rrjedhën *(flow based)* çon në një rritje të efikasitetit ekonomik në rajonin e llogaritjes së kapacitetit me të njëjtin nivel sigurie të sistemit;

b) transparenca dhe saktësia e rezultateve të bazuara në rrjedhën *(flow based)* janë konfirmuar në rajonin e llogaritjes së kapacitetit;

c) OST-të u ofrojnë pjesëmarrësve të tregut gjashtë muaj për të përshtatur proceset e tyre.

6. Kur aplikohet një analizë sigurie e bazuar në skenarë të shumtë për zhvillimin e metodologjisë së llogaritjes së kapacitetit në një rajon të llogaritjes së kapacitetit, kërkesat për llogaritjen e kapacitetit, do të zbatohet kur është e përshtatshme, qasja e llogaritjes së kapacitetit dhe vlerësimin e kapacitetit ndërzonal, siç parashikohet në nenin 21(1) të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, përveç nenit 21(1)(a)(iv).

7. Gjatë zhvillimit të metodologjisë së llogaritjes së kapacitetit, do të merren parasysh kërkesat për procedurat alternative dhe kërkesat e parashikuara në nenin 21(3) të rregullores

(BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 11
Metodologjia e margjinës së besueshmërisë

Propozimi për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit do të përfshijë një metodologji të marzhit të besueshmërisë, e cila do të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 22 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 12
Metodologjitë për kufijtë e sigurisë operacionale dhe të paparashikuara

Propozimi për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit do të përfshijë metodologjitë për kufijtë e sigurisë operacionale dhe të paparashikuara, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 23, pikat 1 dhe 2, të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 13
Metodologjia për faktorët e zhvendosjes së gjenerimit

Propozimi për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit do të përfshijë një metodologji për të përcaktuar faktorët e ndërrimit të gjenerimit, që duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 24 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 14
Metodologjia e veprimeve përmirësuese

Nëse masat korrigjuese merren parasysh në llogaritjen afatgjatë të kapacitetit, çdo OST do të sigurojë që ato veprime korrigjuese të jenë teknikisht të disponueshme në operimin në kohë reale dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 25 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 15
Metodologjia e vlerësimit të kapacitetit ndërzonal

Propozimi për një metodologji të përbashkët të llogaritjes së kapacitetit do të përfshijë një metodologji vlerësimi ndërzonal, e cila do të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 26 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 16
Metodologjia për ndarjen e kapacitetit afatgjatë ndërzonal

1. Jo më vonë se dorëzimi i metodologjisë së llogaritjes së kapacitetit të përmendur në nenin 10, OST-të e çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit do të zhvillojnë së bashku një propozim për një metodologji për ndarjen e kapacitetit ndërzonal afatgjatë në mënyrë të koordinuar midis kornizave të ndryshme kohorë brenda rajonit përkatës. Ky propozim duhet t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me nenin 6.

2. Metodologjia për ndarjen e kapacitetit ndërzonal afatgjatë duhet të jetë në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) Do të plotësojë nevojat mbrojtëse të pjesëmarrësve të tregut;

b) Duhet të jetë koherent me metodologjinë e llogaritjes së kapacitetit;

c) Nuk do të çojë në kufizime në konkurrencë, veçanërisht për aksesin në të drejtat afatgjata të transmetimit.

SEKSIONI 3
MODELI I PËRBASHKËT I RRJETIT

Neni 17
Metodologjia për dërgimin e të dhënave të prodhimit dhe ngarkesës

Neni 18
Metodologjia e përbashkët e rrjetit

Neni 19
Skenarët

1. Të gjitha OST-të në rajonet e llogaritjes së kapacitetit, ku zbatohet analiza e sigurisë, e bazuar në skenarë të shumtë në përputhje me nenin 10, do të aplikojnë bashkërisht grupin e skenarëve të zhvilluar në përputhje me nenin 18 të rregullores (BE) 2015/1222, për t'u përdorur në modelin e rrjetit të përbashkët për çdo kornizë kohore të llogaritjes afatgjatë të kapacitetit.

Neni 20
Modeli individual i rrjetit

Kur zhvillohet modeli individual i rrjetit për një kornizë kohore të llogaritjes afatgjatë të kapacitetit në rajonet e llogaritjes së kapacitetit, aty ku zbatohet analiza e sigurisë e bazuar në skenarë të shumtë, në përputhje me nenin 10, çdo OST do të zbatojë kërkesat e përcaktuara në nenin 19 të rregullores (BE) 2015. /1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

SEKSIONI 4

PROCESI I LLOGARITJES SË KAPACITETIT

Neni 21
Dispozitat e përgjithshme

1. Jo më vonë se gjashtë muaj pas mbarimit të afatit për transpozimin e kësaj Rregullore, të gjitha OST-të në secilin rajon të llogaritjes së kapacitetit, do të zhvillojnë së bashku rregulla operacionale për kornizat kohore të llogaritjes afatgjata të kapacitetit, duke plotësuar rregullat e përcaktuara për operacionin për bashkimin e modeleve individuale të rrjetit, në përputhje me nenin 27 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

2. Llogaritësit e koordinuar të kapacitetit të vendosur në nenin 27 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, do të llogarisë kapacitetet ndërzonale afatgjata për rajonin e tyre të llogaritjes së kapacitetit. Për këtë qëllim, jo më vonë se gjashtë muaj pas miratimit të metodologjisë së llogaritjes së kapacitetit për kornizat kohore afatgjata të përmendura në nenin 10, të gjitha OST-të në secilin rajon të llogaritjes së kapacitetit do të zhvillojnë së bashku rregulla operacionale për kornizat kohore afatgjata të llogaritjes së kapacitetit. Rregullat e përcaktuara për funksionimin e llogaritësve të koordinuar të kapacitetit në përputhje me nenin 27 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

3. Kërkesat përkatëse të përcaktuara në nenin 27 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, do të aplikohet për kornizat kohore të llogaritjes së kapacitetit afatgjatë.

Neni 22
Krijimi i një modeli të përbashkët të rrjetit

Procesi dhe kërkesat e përcaktuara në nenin 28 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC për bashkimin në një model të përbashkët të rrjetit, do të zbatohen kur krijohet modeli i përbashkët i rrjetit për periudhat e llogaritjes së kapacitetit afatgjatë në rajonet e llogaritjes së kapacitetit, ku aplikohet analiza e sigurisë bazuar në skenarë të shumtë në përputhje me nenin 10.

Neni 23
Llogaritjet rajonale të kapaciteteve ndërzonale afatgjata

1. Kur OST-të zbatojnë qasjen statistikore në përputhje me nenin 10, procesi për llogaritjen e kapacitetit ndërzonal afatgjatë do të përfshijë të paktën:

a) një përzgjedhje të të dhënave historike të kapacitetit të ditës në avancë ose brenda ditës nga një periudhë e vetme ose një grup periudhash dhe renditja e të dhënave në një kurbë kohëzgjatjeje;

b) një llogaritje të kapacitetit që i përgjigjet nivelit të rrezikut për grupin e të dhënave të përzgjedhura;

c) një llogaritje të kapacitetit ndërzonal afatgjatë që do të ofrohet për alokimin e kapaciteteve,

duke marrë parasysh një diferencë për të pasqyruar diferencën midis vlerave historike të kapacitetit ndërzonal dhe vlerave afatgjata të parashikuara të kapacitetit ndërzonal;

d) rregulla të përbashkëta për të marrë parasysh informacionin e disponueshëm për ndërprerjet e planifikuara, infrastrukturën e re dhe modelin e gjenerimit dhe ngarkesës për kohën e llogaritjes së kapacitetit afatgjatë

2. Kur OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmetimit) aplikojnë analizën e sigurisë bazuar në skenarë të shumtë në përputhje me nenin 10, kërkesat e përcaktuara në nenin 29 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, përveç nenit 29(4), kur është e nevojshme, do të zbatohen për periudhat e llogaritjes së kapacitetit afatgjatë në rajonet e llogaritjes së kapacitetit.

3. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të ndajë kapacitetin e llogaritur afatgjatë ndërzonal për çdo alokim afatgjatë të kapacitetit, duke aplikuar metodologjinë për ndarjen e kapacitetit ndërzonal në përputhje me nenin 16.

4. Çdo llogaritës i kapacitetit të koordinuar do të dërgojë për validim kapacitetin e llogaritur afatgjatë ndërzonal dhe ndarjen e kapacitetit afatgjatë ndërzonal te çdo OST brenda rajonit përkatës të llogaritjes së kapacitetit në përputhje me nenin 24.

Neni 24

Validimi dhe dorëzimi i kapacitetit ndërzonal dhe ndarjes së kapacitetit ndërzonal

1. Çdo OST do të validojë rezultatet e llogaritjes për kapacitetin afatgjatë ndërzonal në kufijtë ndërzonal ose elementet kritike të rrjetit për çdo periudhë kohore të llogaritjes së kapacitetit afatgjatë në përputhje me nenin 15.

2. Çdo OST do të vërtetojë rezultatet e llogaritjes për ndarjen e kapacitetit afatgjatë ndërzonal në kufijtë ndërzonal ose elementet kritike të rrjetit në përputhje me nenin 16.

3. Çdo OST do të dërgojë vlerësimin e kapacitetit të tij dhe ndarjen e vlefshme të këtij kapaciteti për çdo alokim të kapacitetit afatgjatë të llogaritësit përkatës të koordinuar të kapacitetit dhe të OST-të e tjera të rajoneve përkatëse të llogaritjes së kapacitetit.

4. Ndarja e vërtetuar e kapacitetit ndërzonal afatgjatë do të sigurohet nga çdo llogaritës i koordinuar i kapacitetit për ekzekutimin e alokimit të kapacitetit të ardhshëm, në përputhje me nenin 29.

5. OST-të, sipas kërkesës, do t'u ofrojnë autoriteteve të tyre rregullatore një raport që detajon se si është marrë vlera e kapacitetit afatgjatë ndërzonal për një kornizë kohore specifike të llogaritjes së kapacitetit afatgjatë.

Neni 25

Kufizimi i koordinuar i kapacitetit ndërzonal

1. OST-të do të koordinojnë kufizimet e kapacitetit ndërzonal afatgjatë të alokuar, nëse kufizimet kanë të bëjnë me një kornizë kohore prej më shumë se 48 orë përpara fillimit të ditës së dorëzimit. Në rast të kufizimit të të drejtave afatgjata të transmetimit, duke përfshirë

nominimet në lidhje me këto të drejta, brenda 48 orëve përpara fillimit të ditës së livrimit OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të zbatojnë procesin e llogaritjes së kapacitetit të ditës në avancë dhe brenda ditës, siç përcaktohet në nenin 29 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

2. Nëse një OST ka nevojë të kufizojë kapacitetin ndërzonal afatgjatë të alokuar, ai duhet t'i dërgojë një kërkesë llogaritësit përkatës të kapacitetit të koordinuar për të nisur llogaritjen e koordinuar të kufizimeve të nevojshme të kapacitetit ndërzonal afatgjatë për rajonin e llogaritjes së kapacitetit. OST do të mbështesë kërkesën e tij me të gjithë informacionin përkatës.

3. Llogaritësi i kapacitetit të koordinuar do të sigurojë kapacitetin e përditësuar ndërzonal për OST-të përkatëse për validim.

4. Çdo OST do të vërtetojë kapacitetin e përditësuar ndërzonal në kufijtë e zonës së tij të ofertave ose elementet kritike të rrjetit në përputhje me nenin 24.

5. Llogaritësi i koordinuar i kapacitetit do t'u sigurojë OST-ve përkatëse kapacitetin e përditësuar të vlefshëm ndërzonal dhe platformën e vetme të alokimit për të kryer kufizimin, në përputhje me nenin 53.

SEKSIONI 5
RAPORT DYVJEÇAR PËR LLOGARITJEN E KAPACITETIT

Neni 26
Raport dyvjeçar për llogaritjen dhe alokimin e kapaciteteve

1. Jo më vonë se dy vjet pas mbarimit të afatit për transpozim të kësaj Rregulloreje, ENTSO për Energji Elektrike, duke vepruar në përputhje me nenin 3 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC do të zgjerojë raportet për llogaritjen dhe alokimin e kapaciteteve afatgjata të hartuara, në përputhje me nenin 26(1) dhe (2) të Rregullores (BE) 2016/1719 për të përfshirë Palët Kontraktuese. Në rast se raporti mbulon OST-të nga Palët Kontraktuese që nuk janë pjesë e operacionit të sinkronizuar kontinental ose joanëtare të ENTSO-s për Energjinë Elektrike, Sekretariati do të koordinojë kontributet përkatëse.

2. ...

3. Për secilën zonë të ofertimit, kufirin e zonës së ofertimit dhe rajonin e llogaritjes së kapacitetit, raporti mbi llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit duhet të përmbajë të paktën:

a) Qasjen e përdorur për llogaritjen e kapacitetit;

b) Treguesit statistikorë mbi marzhet e besueshmërisë;

c) Treguesit statistikorë të kapacitetit ndërzonal, sipas rastit për çdo kornizë kohore të llogaritjes së kapacitetit;

d) Tregues të cilësisë për informacionin e përdorur për llogaritjen e kapacitetit;

e) Aty ku është e përshtatshme, masat e propozuara për të përmirësuar llogaritjen e kapacitetit;

f) Rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të llogaritjes së kapaciteteve afatgjata, duke përfshirë harmonizimin e mëtejshëm të metodologjive, proceseve dhe marrëveshjeve qeverisëse.

3. Për raportin, OST-të duhet të përdorin treguesit statistikorë dhe cilësorë të rënë dakord, në përputhje me nenin 26 të rregullores (BE) 2016/1719. Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC mund të kërkojë ndryshimin e këtyre treguesve <...> gjatë aplikimit.

KAPITULLI 2
ZONAT E OFERTIMIT

Neni 27
Dispozitat e përgjithshme

1. Zonat e ofertimit të zbatueshme për tregtimin e ditës në avancë dhe atë brenda ditës do të zbatohen për llogaritjen dhe alokimin e kapacitetit të ardhshëm.

2. Kur një kufi i zonës së ofertimit nuk ekziston më, mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit në këtë kufi të zonës së ofertimitdo të kenë të drejtën e rimbursimit nga OST-të përkatëse, bazuar në çmimin fillestar të paguar për të drejtat afatgjata të transmetimit.

KAPITULLI 3
ALOKIMI I KAPACITETEVE AFATGJATA

SEKSIONI 1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 28
Parimet e përgjithshme

Alokimi i kapacitetit afatgjatë do të bëhet në mënyrë që:

a) Përdor parimin e çmimit marxhinal për të gjeneruar rezultate për çdo kufi të zonës së ofertimit, drejtimin e përdorimit dhe njësinë e kohës së tregut;

b) Alokon jo më shumë se kapacitetin ndërzonal afatgjatë të ofruar në përputhje me nenin 39;

c) Është e përsëritshme.

Neni 29
Të dhënat dhe rezultatet

1. Platforma e vetme e alokimit do të përdorë inputet e mëposhtme për përcaktimin e alokimit të kapacitetit afatgjatë në përputhje me paragrafin 2:

a) Ndarja e pranuar e kapacitetit ndërzonal afatgjatë të paraqitur nga çdo llogaritës i koordinuar i kapaciteteve dhe kapaciteteve të lidhura me të drejtat e kthyera afatgjata të transmetimit në përputhje me nenin 43;

b) Ofertat e paraqitura nga pjesëmarrësit e tregut.

2. Për çdo alokim të kapacitetit afatgjatë, platforma e vetme e alokimit do të përcaktojë njëkohësisht të paktën rezultatet e mëposhtme për çdo kufi të zonës së ofertimit drejtimin e përdorimit dhe njësinë kohore të tregut:

a) Vëllimin e të drejtave afatgjata të transmetimit të alokuara të shprehura në mw;

b) Çmimin e të drejtave afatgjata të transmetimit sipas nenit 40;

c) Statusin e ekzekutimit të ofertave;

3. Platforma e vetme e alokimit duhet të sigurojë që rezultatet e ankandit janë të sakta.

4. Çdo OST do të sigurojë që rezultatet e ankandit të jenë në përputhje me të dhënat e dërguara për platformën e vetme të alokimit në përputhje me paragrafin 1.

SEKSIONI 2
OPSIONET PËR MBROJTJEN E RREZIKUT TË TRANSMETIMIT NDËRZONAL

Neni 30
Vendim për mundësitë e mbrojtjes së rrezikut ndërzonal

1. OST-të në kufirin e zonës së ofertimit duhet të lëshojnë të drejta afatgjata transmetimi, përveçse nëse autoritetet rregullatore kompetente të kufirit të zonës së ofertimit kanë miratuar vendime të koordinuara për të mos lëshuar të drejta afatgjata transmetimi në kufirin e zonës së ofertimit. Kur miratojnë vendimet e tyre, autoritetet rregullatore kompetente të kufirit të zonës së ofertimit duhet të konsultohen me autoritetet rregullatore të rajonit përkatës të llogaritjes së kapacitetit dhe të marrin parasysh mendimet e tyre.

2. Kur të drejtat afatgjatë të transmetimit nuk ekzistojnë në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, autoritetet rregullatore kompetente të kufirit të zonës së ofertimit duhet të miratojnë vendime të koordinuara për hyrjen në fuqi të të drejtave afatgjatë të transmetimit jo më vonë se gjashtë muaj pas skadimit të afatit për miratimin e kësaj Rregulloreje.

3. Vendimet në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 duhet të bazohen në një vlerësim, i cili do të identifikojë nëse tregu i energjisë për periudha të ardhshme ofron mundësi të mjaftueshme mbrojtjeje për zonat e ofertimit të përfshira. Vlerësimi duhet të kryhet në mënyrë të koordinuar nga autoritetet rregullatore kompetente të kufirit të zonës së ofertimit dhe duhet të përfshijë të paktën:

a) një konsultim me pjesëmarrësit e tregut, në lidhje me nevojat e tyre për mundësitë e mbrojtjes së rrezikut ndërzonal në kufijtë e zonës përkatëse të ofertimit;

b) një vlerësim.

4. Vlerësimi i përmendur në paragrafin 3(b) do të hetojë funksionimin e tregjeve me shumicë të energjisë elektrike dhe do të bazohet në kritere transparente të cilat përfshijnë të paktën:

a) një analizë nëse produktet ose kombinimi i produkteve të ofruara në tregjet në avancë përfaqësojnë një mbrojtje kundrejt paqëndrueshmërisë së çmimit të ditës në avancë të zonës përkatëse të ofertimit. Ky produkt ose kombinim produktesh do të konsiderohet si një mbrojtje e përshtatshme ndaj rrezikut të ndryshimit të çmimit të ditës në avancë të zonës përkatëse të ofertimit, kur ka një korrelacion të mjaftueshëm midis çmimit të ditës në avancë të zonës përkatëse të ofertimit dhe çmimit bazë. kundrejt të cilit shlyhet produkti ose kombinimi i produkteve;

b) një analizë nëse produktet ose kombinimet e produkteve të ofruara në tregjet në avancë janë efikase; për këtë qëllim, duhet të vlerësohen të paktën treguesit e mëposhtëm:

i. periudha e tregtimit marzhi midis ofertës dhe kërkesës

ii. vëllimet e tregtuara në lidhje me konsumin fizik;

iii. interesi i hapur në lidhje me konsumin fizik.

5. Në rast se vlerësimi i përmendur në paragrafin 3 tregon se ka mundësi të pamjaftueshme mbrojtëse në një ose më shumë zona tenderuese, autoritetet rregullatore kompetente do t'u kërkojnë OST-ve përkatëse:

a) të lëshojë të drejtë afatgjata të transmetimit; ose

b) për t'u siguruar që produkte të tjera mbrojtëse ndërzonale afatgjata të vihen në dispozicion për të mbështetur funksionimin e tregjeve me shumicë të energjisë elektrike.

6. Në rast se autoritetet rregullatore kompetente zgjedhin të lëshojnë një kërkesë, siç përmendet në paragrafin 5(b), OST-të përkatëse do të zhvillojnë aranzhimet e nevojshme dhe do t'i paraqesin ato në miratimin e autoriteteve rregullatore kompetente, jo më vonë se gjashtë muaj pas kërkesës nga autoriteti kompetent rregullator. Këto marrëveshje të nevojshme do të zbatohen jo më vonë se gjashtë muaj pas miratimit nga autoritetet rregullatore kompetente. Autoritetet rregullatore kompetente mund të zgjasin kohën e zbatimit me kërkesë të OST-ve përkatëse me një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

7. Kur autoritetet rregullatore vendosin që të drejtat afatgjatë të transmetimit nuk do të emëtohen nga OST-të përkatëse ose që produkte të tjera mbrojtëse afatgjata ndërzonale do të vihen në dispozicion nga OST-të përkatëse, nenet 16, 28, 29, 31 deri në 57, 59 dhe 61 nuk do të zbatohet për OST-të e kufijve të zonës së ofertimit.

8. Me një kërkesë të përbashkët të OST-ve në kufirin e zonës së ofertimit ose me iniciativën e tyre, dhe të paktën çdo 4 vjet, autoritetet rregullatore kompetente të kufirit të zonës së ofertimit do të kryejnë, në bashkëpunim me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, një vlerësim sipas paragrafëve 3 deri në 5.

Neni 31

Projektimi rajonal i të drejtave afatgjata të transmetimit

1. Kapaciteti ndërzonal afatgjatë do t'u shpërndahet pjesëmarrësve të tregut nga platforma e alokimit në formën e të drejtave fizike të transmetimit, në përputhje me parimin UIOSI ose në formën e detyrimeve FTR – opsione ose FTRs.

2. Të gjitha OST-të që lëshojnë të drejta transmetimi afatgjatë do të ofrojnë kapacitet afatgjatë ndërzonal, përmes platformës së vetme të alokimit të përmendura në nenin 48, për pjesëmarrësit e tregut për të paktën korniza kohore vjetore dhe mujore. Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit mund të propozojnë së bashku ofrimin e kapaciteteve ndërzonale afatgjatë në korniza kohore shtesë.

3. Jo më vonë se gjashtë muaj nga mbarimi i afatit për transpozim të kësaj Rregulloreje, OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit ku ekzistojnë të drejtat afatgjata të transmetimit do të zhvillojnë së bashku një propozim për hartimin rajonal të të drejtave afatgjata të transmetimit që do të emëtohen në çdo kufi të zonës së ofertimit brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit.

Jo më vonë se gjashtë muaj pas vendimeve të koordinuara të autoriteteve rregullatore të kufirit të zonës së ofertimit për të futur të drejtat afatgjata të transmetimit në përputhje me nenin 30(2), OST-të e rajonit përkatës të llogaritjes së kapacitetit, do të zhvillojnë së bashku një propozim për projektim rajonal të të drejtat afatgjata të transmetimit që do të emëtohen në çdo kufi të zonës së ofertimit brenda rajonit përkatës të llogaritjes së kapacitetit.

Autoritetet rregullatore të Palëve Kontraktuese dhe Shtetet anëtare në të cilat projektimi rajonal i të drejtave afatgjata të transmetimit është pjesë e një marrëveshjeje të ridërgimit ndërkufitar të OST-së, me qëllim të sigurimit që operacioni të mbetet brenda kufijve të sigurisë operacionale, mund të vendosin të ruajnë të drejtat fizike afatgjata të transmetimit në kufijtë e zonës së ofertimit.

3. Propozimet e përmendura në paragrafin 3 do të përfshijnë një plan kohor për zbatimin dhe të paktën përshkrimin e pikave të mëposhtme të specifikuara në rregullat e alokimit:

a) lloji i të drejtave afatgjata të transmetimit;

b) kornizat kohore të alokimit të kapaciteteve afatgjata;

c) forma e produktit (ngarkesa bazë, ngarkesa maksimale, ngarkesa jashtë pikut);

d) kufijtë e zonës së tenderit të mbuluar.

5. Propozimet do t'i nënshtrohen konsultimit në përputhje me nenin 6. Për të emëtuar të drejtat e propozuara afatgjata të transmetimit, çdo OST do të marrë parasysh, siç duhet rezultatin e konsultimit.

6. Nuk lejohet alokimi i të drejtave fizike të transmetimit dhe FTR-ve – opsionet paralelisht në të njëjtin kufi të zonës së ofertimit. Nuk lejohet alokimi i të drejtave fizike të transmetimit dhe detyrimeve të FTR-ve në mënyrë paralele në të njëjtën zonë të kufirit të tenderit.

7. Një rishikim i të drejtave afatgjata të transmetimit të ofruara në një kufi të zonës së ofertimit mund të nisë nga:

a) të gjitha autoritetet rregullatore të kufirit të zonës së ofertave, me iniciativën e tyre; ose

b) të gjitha autoritetet rregullatore të kufirit të zonës së ofertimit bazuar në rekomandimin e Bordi Rregullator të Komunitetit të Energjisë, ose, në rast se preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, ose kërkesë të përbashkët nga të gjitha OST-të e kufirit përkatës të zonës së ofertimit.

8. Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të jenë përgjegjës për ndërmarrjen e rishikimit, siç parashikohet në paragrafin 9.

9. Çdo OST e përfshirë në rishikimin e të drejtave afatgjata të transmetimit duhet:

a) të vlerësojë të drejtat e ofruara afatgjata të transmetimit, duke marrë parasysh karakteristikat në paragrafin 4;

b) nëse konsiderohet e nevojshme, propozon të drejta alternative të transmetimit afatgjatë, duke marrë parasysh rezultatin e vlerësimit në nënparagrafin (a);

c) të kryej një konsultim në përputhje me nenin 6, në lidhje me:

i. rezultatet e vlerësimit të të drejtave të ofruara afatgjata të transmetimit;

ii. nëse është e aplikueshme, propozimi për të drejta alternative të transmetimit afatgjatë.

10. Pas konsultimit të përmendur në paragrafin 9(c) dhe brenda tre muajve nga nxjerrja e vendimit për të nisur një rishikim, OST-të e rajonit të llogaritjes së kapacitetit në fjalë do t'i paraqesin së bashku një propozim autoriteteve rregullatore kompetente për të ruajtur ose ndryshuar llojin e të drejtave afatgjata të transmetimit.

Neni 32

Të drejtat e transmetimit fizik

1. Çdo mbajtës i së drejtës fizike të transmetimit ka të drejtë të emërojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave të tij fizike të transmetimit në përputhje me nenin 36.

2. Kur mbajtësit e të drejtave fizike të transmetimit nuk bëjnë një nominim brenda afatit të përcaktuar në rregullat e nominimit, ata kanë të drejtë të marrin kompensim në përputhje me nenin 35.

Neni 33

Të drejtat financiare të transmetimit – opsionet

1. Mbajtësit e FTR-ve – opsionet kanë të drejtë të marrin kompensim, në përputhje me nenin 35.

2. Zbatimi i opsioneve të FTR-ve do t'i nënshtrohet aplikimit të bashkimit të çmimeve të ditës në avancë, në përputhje me nenet 38 deri në 50 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 34

Të drejtat financiare të transmetimit – detyrimet

1. Mbajtësit e detyrimeve të FTR-ve kanë të drejtë të marrin ose të detyrohen të paguajnë kompensimin financiar sipas nenit 35.

2. Zbatimi i FTR-ve – detyrimet do t'i nënshtrohen aplikimit të lidhjes së çmimeve të ditës në vijim sipas neneve 38 deri në 50 të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC

Neni 35

Parimet për kompensimin e të drejtave të afatgjatë të transmetimit

1. OST-të përkatëse që kryejnë alokimin e të drejtave të transmetimit në kufirin e zonës së ofertimit përmes platformës së vetme të alokimit do të kompensojnë mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit, në rast se diferenca e çmimit është pozitive në drejtim të të drejtave afatgjata të transmetimit.

2. Mbajtësit e detyrimeve të FTR-ve do të kompensojnë OST-të përkatëse përmes platformës së vetme të alokimit që alokon të drejtat e transmetimit në kufirin e zonës së ofertave në rast se diferenca e çmimit është negative në drejtim të detyrimeve të FTR-ve.

3. Kompensimi i të drejtave afatgjata të transmetimit në paragrafët 1 dhe 2 do të jetë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) kur kapaciteti ndërzonal alokohet nëpërmjet alokimit të nënkuptuar ose një metode tjetër që rezulton nga një procedurë alternative në harkun kohor të ditës në avancë, kompensimi i të drejtave të transmetimit afatgjatë do të jetë i barabartë me diferencën e tregut;

b) kur kapaciteti ndërzonal alokohet nëpërmjet ankandit të qartë në harkun kohor të ditës në avancë, kompensimi i të drejtave afatgjata të transmetimit do të jetë i barabartë me çmimin e klerues të ankandit ditor.

4. Në rast se kufizimet e alokimit në ndërlidhjet ndërmjet zonave të tenderit janë përfshirë në procesin e alokimit të kapacitit të ditës në avancë, në përputhje me nenin 23(3) të rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, ato mund të merren parasysh për llogaritjen e kompensimit të të drejtave afatgjata të transmetimit sipas paragrafit 3.

SEKSIONI 3

PROCEDURAT E NOMINIMIT PËR TË DREJTAT E TRANSMETIMIT FIZIK

Neni 36

Dispozitat e përgjithshme për nominimin e të drejtave fizike të transmetimit

1. Kur OST-të lëshojnë dhe zbatojnë të drejta fizike të transmetimit në kufijtë e zonës së ofertimit, ato do t'u mundësojnë mbajtësve të të drejtave fizike të transmetimit dhe/ose palëve të tyre të nominojnë oraret e tyre të shkëmbimit të energjisë elektrike. Mbajtësit e të drejtave të transmetimit fizike mund të autorizojnë palët e treta të kualifikuara që të nominojnë oraret e tyre të shkëmbimit të energjisë elektrike në emër të tyre, në përputhje me rregullat e nominimit në përputhje me paragrafin 3.

2. Jo më vonë se 12 muaj nga mbarimi i afatit për transpozim të kësaj Rregulloreje, të gjitha OST-të që lëshojnë të drejta të transmetimit fizik në kufirin e zonës së ofertave duhet t'i paraqesin për miratim autoriteteve rregullatore përkatëse një propozim për rregullat e nominimit për oraret e shkëmbimit të energjisë elektrike ndërmjet zonave të ofertimit. Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimit në përputhje me nenin 6. Rregullat e nominimit duhet të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) të drejtën e një mbajtësi të të drejtave fizike të transmetimit për të nominuar oraret e shkëmbimit të energjisë elektrike;

b) kërkesat minimale teknike për të nominuar;

c) përshkrimi i procesit të nominimit;

d) oraret e nominimit;

e) formati i nominimit dhe komunikimit.

3. Të gjitha OST-të do të harmonizojnë në mënyrë progresive rregullat e nominimit në të gjitha kufijtë e zonave të ofertimit në të cilat zbatohen të drejtat fizike të transmetimit.

4. Mbajtësit e të drejtave të transmetimit fizik, palët e tyre, sipas rastit, ose një palë e tretë e autorizuar që vepron në emër të tyre do të emërojnë të gjitha ose një pjesë të të drejtave të tyre fizike të transmetimit ndërmjet zonave të ofertave në përputhje me rregullat e nominimit.

5. Në rast se kufizimet e alokimit në interkoneksionet ndërmjet zonave të ofertimit janë përfshirë në procesin e alokimit të kapaciteteve të ditës në avancë në përputhje me nenin 23(3) të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, ata do të merren parasysh në propozimin për rregullat e nominimit të përmendura në paragrafin 2.

Neni 37

Termat dhe kushtet për pjesëmarrje në alokimin e kapaciteteve afatgjata

1. Pjesëmarrësit e tregut do të regjistrohen në platformën e vetme të alokimit të përmendura në nenin 48 dhe të plotësojnë të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë, sipas rregullave të harmonizuara të alokimit përpara se të kenë të drejtë të marrin pjesë në ankande ose të transferojnë të drejtat e tyre afatgjata të transmetimit. Kërkesat e pranueshmërisë duhet të jenë në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës.

2. Pas kërkesës së një pjesëmarrësi në treg për regjistrim, platforma e vetme e alokimit do të njoftojë pjesëmarrësin e tregut, nëse i plotëson të gjitha kërkesat për t'u pranuar dhe nëse ka të drejtë të marrë pjesë në ankande ose të transferojë të drejtat e tij afatgjata të transmetimit nga një datë e caktuar.

3. Pjesëmarrësit e tregut duhet të respektojnë plotësisht rregullat e harmonizuara të alokimit. Ata do të mbajnë të përditësuar të gjithë informacionin, në lidhje me pjesëmarrjen e tyre dhe do të njoftojnë pa vonesë në platformën e vetme të alokimit për çdo ndryshim në këtë informacion.

4. Platforma e vetme e alokimit do të ketë të drejtë të pezullojë ose të tërheqë të drejtën e një pjesëmarrësi të tregut për të marrë pjesë në ankande ose për të transferuar të drejtat e tij afatgjata të transmetimit pas një shkeljeje të detyrimeve kontraktuale, sipas rregullave të harmonizuara të alokimit.

5. Pezullimi ose tërheqja e së drejtës së pjesëmarrësit të tregut për të marrë pjesë në ankande ose për të transferuar të drejtën e tij afatgjatë të transmetimit, në përputhje me rregullat e harmonizuara të alokimit nuk do të shmangë një pjesëmarrës në treg ose platformën e vetme të alokimit nga detyrimet e tyre që rrjedhin nga transmetimi afatgjatë, të drejtat e alokuara dhe të paguara përpara pezullimit ose tërheqjes.

Neni 38

Dorëzimi i të dhënave hyrëse në platformën e vetme të alokimit

Çdo OST do të sigurojë që ndarja e vërtetuar e kapacitetit ndërzonal afatgjatë do të dorëzohet në platformën e vetme të alokimit përpara publikimit të specifikimeve të ankandit, në përputhje me nenin 39.

Neni 39

Operimi i alokimit të kapacitetit afatgjatë

1. Jo më vonë se koha e caktuar në rregullat e harmonizuara të alokimit për çdo alokim të kapacitetit afatgjatë, një specifikim ankandi që përmban të paktën informacionin e mëposhtëm do të përcaktohet dhe publikohet në platformën e vetme të alokimit:

a) data dhe ora e hapjes së portës dhe e mbylljes së portës së ankandit;

b) vërtetimi i ndarjes së kapacitetit ndërzonal afatgjatë dhe llojin e të drejtave afatgjata të transmetimit që do të dalin në ankand;

c) formati i ofertave;

d) data dhe ora e publikimit të rezultateve të ankandit;

e) periudha gjatë së cilës mund të kontestohen rezultatet e ankandit.

2. Kapaciteti ndërzonal afatgjatë i publikuar nuk do të modifikohet gjatë një periudhe përpara mbylljes së portës së ankandit. Rregullat e harmonizuara të alokimit do të specifikojnë atë periudhë.

3. Çdo pjesëmarrës i tregut do të dorëzojë ofertat e tij në platformën e vetme të alokimit përpara kohës së mbylljes së portës dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet e ankandit.

4. Platforma e vetme e alokimit do të sigurojë konfidencialitetin e ofertave të dorëzuara

Neni 40

Çmimi i të drejtave afatgjata të transmetimit

Çmimi i të drejtave afatgjata të transmetimit për secilën kufi të zonës së ofertimit, drejtimin e shfrytëzimit dhe njësinë e kohës së tregut do të përcaktohet në bazë të parimit të çmimit

marxhinal dhe i shprehur në euro për megavat. Në rast se kërkesa për kapacitetin afatgjatë ndërzonal për kufirin e zonës së ofertimit, drejtimin e shfrytëzimit dhe njësinë e kohës së tregut është më e ulët ose e barabartë me kapacitetin ndërzonal afatgjatë të ofruar, çmimi do të jetë zero.

Neni 41
Kërkesat financiare dhe shlyerja

1. Platforma e vetme e alokimit do të ofrojë procedura faturimi ose vetëfaturimi për shlyerjen e debive ose kredive që rrjedhin nga ndarja e të drejtave afatgjata të transmetimit, kthimi i të drejtave afatgjata të transmetimit dhe kompensimi i të drejtave afatgjata të transmetimit. Rregullat e harmonizuara të alokimit do të specifikojnë ato procedura.
2. Për të marrë pjesë në ankande, një pjesëmarrës i tregut duhet të ketë kolaterale të mjaftueshme për të siguruar oferta dhe të drejta afatgjata të transmetimit të alokuara, në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregullat e harmonizuara të alokimit.

Neni 42
Procedurat alternative

1. Në rast se alokimi i kapacitetit afatgjatë nuk është në gjendje të prodhojë rezultate, procedura alternative do të jetë shtyrja e alokimit të kapacitetit afatgjatë.
2. Të gjitha OST-të në secilin rajon të llogaritjes së kapacitetit do të kenë të drejtën të zbatojnë zgjidhje alternative të koordinuara. Në raste të tilla, të gjitha OST-të në secilin rajon të llogaritjes së kapacitetit do të zhvillojnë një propozim të koordinuar për procedura të besueshme alternative.

Neni 43
Kthimi i të drejtave afatgjata të transmetimit

1. Mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit mund t'i kthejnë të drejtat e tyre afatgjata të transmetimit tek OST-të përkatëse përmes platformës së vetme të alokimit për alokimin e kapacitetit afatgjatë.
2. Mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit që dëshirojnë të kthejnë të drejtat e tyre afatgjata të transmetimit për alokimin e kapacitetit afatgjatë duhet ta njoftojnë këtë, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një pale të tretë, në platformën e vetme të alokimit, siç përcaktohet në rregullat e harmonizuara të alokimit.
3. Mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit që kthejnë të drejtat e tyre afatgjata të transmetimit do të paguhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një pale të tretë, nga OST-të përkatëse nëpërmjet platformës së vetme të alokimit të përmendura në nenin 48. Një kompensim i tillë do të jetë i barabartë me çmimin që rezulton nga ankandi ku rialokohen të drejtat afatgjata të transmetimit.

Neni 44
Transferimi i të drejtave afatgjata të transmetimit

1. Mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit do të kenë të drejtë të transferojnë të gjitha ose një pjesë të të drejtave të tyre afatgjata të transmetimit te pjesëmarrësit e tjerë të tregut, në përputhje me rregullat e harmonizuara të alokimit.

2. Rregullat për pranueshmërinë dhe një listë e pjesëmarrësve të tregut të regjistruar në platformën e vetme të alokimit dhe të kualifikuar për të transferuar të drejtat afatgjata të transmetimit do të publikohen në platformën e vetme të alokimit.

3. Mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit duhet të njoftojnë transferimin e të drejtave afatgjata të transmetimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes një pale të tretë, në platformën e vetme të alokimit në përputhje me rregullat e harmonizuara të alokimit.

4. Pjesëmarrësit e tregut që fitojnë këto të drejta transmetimi afatgjata duhet të konfirmojnë, njoftimin e dërguar nga mbajtësi i mëparshëm i të drejtave afatgjatë të transmetimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një pale të tretë, në platformën e vetme të alokimit, në përputhje me rregullat e harmonizuara të alokimit.

Neni 45

Dorëzimi i rezultateve

1. Platforma e vetme e alokimit të përmendura në nenin 48 do të njoftojë OST-të përgjegjëse për kufirin e zonës së ofertimit me të cilin lidhen të drejtat afatgjata të transmetimit, pjesëmarrësit e tregut dhe mbajtësit e të drejtave afatgjata të transmetimit për rezultatin e alokimit të kapacitetit afatgjatë brenda kornizës kohore të parashikuar në specifikimin e ankandit.

2. Platforma e vetme e alokimit do të informojë pjesëmarrësit e tregut për statusin e ekzekutimit dhe çmimet e klerimit të ofertave të tyre.

Neni 46

Fillimi i procedurës alternative

1. Në rast se platforma e vetme e alokimit nuk është në gjendje të japë as specifikimin e ankandit në përputhje me nenin 39 ose një pjesë ose të gjitha rezultatet e alokimit të kapacitetit afatgjatë brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullat e harmonizuara të alokimit, OST-të përgjegjëse për zonën e ofertimit, do të zbatojnë procedurat e alternative të përcaktuara në bazë të nenit 42.

2. Sapo të identifikohet pamundësia e dorëzimit të objektit të përmendur në paragrafin 1, platforma e vetme e alokimit do të njoftojë OST-të përgjegjëse në kufirin e zonës së ofertimit. Platforma e vetme e alokimit do të njoftojë pjesëmarrësit e tregut se mund të zbatohen procedurat alternative.

Neni 47

Publikimi i informacionit të tregut

1. Të paktën informacioni i mëposhtëm për çdo kufi të zonës së ofertimit dhe drejtimin e përdorimit do të publikohet në platformën e vetme të alokimit:

a) specifikimet e ankandit në përputhje me nenin 39;

b) një kalendar indikativ i ankandit që përcakton llojin e të drejtave afatgjata të transmetimit që do të ofrohen dhe datat kur ato të drejta afatgjata të transmetimit do t'u ofrohen pjesëmarrësve

të tregut;

c) rezultatet e alokimit të kapacitetit afatgjatë në përputhje me nenin 29;

d) numrin e pjesëmarrësve të tregut në çdo ankand;

e) listën e pjesëmarrësve të kualifikuar të tregut për transferimin e të drejtave afatgjata të transmetimit;

f) detajet e kontaktit të platformës së vetme të alokimit.

2. OST-të përkatëse do të publikojnë, nëpërmjet platformës së vetme të alokimit, informacionin e kërkuar të përmendur në paragrafin 1, në përputhje me kohën e përcaktuar në specifikimin e ankandit dhe në rregulloren (BE) nr. 543/2013, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2015/01/MC-EnC.

3. Platforma e vetme e alokimit do të sigurojë që të dhënat historike për një periudhë jo më pak se pesë vjet të bëhen publike.

KAPITULLI 4
PLATFORMA RAJONALE E ALOKIMIT

Neni 48
Platforma rajonale e alokimit

1. Të gjitha OST-të e Palëve Kontraktuese do të sigurojnë që një Platforme Rajonale e alokimit është funksionale dhe përputhet me kërkesat funksionale të përcaktuara në nenin 49 brenda 12 muajve pas miratimit të propozimit për një grup të përbashkët kërkesash dhe për vendosjen e një platforme rajonale e alokimit. Autoritetet rregullatore kompetente mund ta zgjasin këtë periudhë me kërkesë të OST-ve përkatëse, për shkak të vonesave në lidhje me procedurat e prokurimit publik me një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

2. Alokimet e kapaciteteve afatgjata në interkoneksionet e rrymës se vazhduar (DC) do të bëhen në një platformë rajonale të alokimit jo më vonë se 24 muaj pas miratimit të përmendur në paragrafin 1.

3. Platforma rajonale e alokimit do të jetë e hapur për pjesëmarrjen e OST-ve të Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta.

4. Për interkoneksionet ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe Shteteve Anëtare, operatorët përkatës të sistemit të transmetimit do të lidhin një marrëveshje dypalëshe jo më vonë se mbarimi i afatit për transpozimin e kësaj Rregulloreje për të përcaktuar nëse alokimet e ardhshme të kapacitetit për interkoneksionin përkatës do të kryhen nga platforma e krijuar në përputhje me këtë nen, ose nga platforma e vetme e alokimit e krijuar në përputhje me nenin 48 të rregullores 2016/1719.

5. Platforma rajonale e alokimit do të kryejë funksionet e saj në bashkëpunim të ngushtë me platformën e vetme të krijuar, në përputhje me nenin 48 të rregullores 2016/1719 dhe do të harmonizojë rregullat e saj operative dhe të alokimit me ato të aplikuara nga platforma e vetme. Për këtë qëllim, platformat mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi administrative.

6. Kur operatorët e sistemit të transmetimit të një Pale Kontraktuese dhe një Shteti Anëtar nuk arrijnë të përfundojnë një marrëveshje të përmendur në paragrafin 4, detyrat e platformës rajonale të alokimit, në lidhje me interkoneksionin ndërmjet asaj Pale Kontraktuese dhe Shtetit Anëtar do të integrohen në platformën e vetme të alokimit të krijuar në pajtim me nenin 48 të

rregullores 2016/1719 në afat prej 18 muajsh pas mbarimit të afatit për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 49
Kërkesat funksionale

1. Brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të gjitha OST-të do t'u paraqesin të gjitha autoriteteve rregullatore një propozim të përbashkët për një sërë kërkesash te platforma rajonale e alokimit në shërbim të OST-ve të Palëve Kontraktuese. Propozimi do të identifikojë opsione të ndryshme për krijimin dhe qeverisjen e platformës rajonale të alokimit, duke përfshirë zhvillimin nga OST ose nga palë të treta në emër të tyre. Propozimi i OST-ve do të mbulojë detyrat e përgjithshme të platformës rajonale të alokimit të parashikuar në nenin 50 dhe kërkesat për mbulimin e kostos në përputhje me nenin 59.

2. Kërkesat funksionale për platformën e vetme të alokimit duhet të përfshijnë të paktën:

a) kufijtë e pritshëm të zonës ofertuese që do të mbulohen;

b) disponueshmërinë teknike dhe besueshmërinë e shërbimeve të ofruara;

c) proceset operative;

d) produktet që do të ofrohen;

e) kornizat kohore të alokimit të kapacitetit afatgjatë;

f) metodat dhe algorimet e alokimit;

g) parimet e shlyerjes financiare dhe menaxhimit të rrezikut të produkteve të alokuara;

h) një kornizë kontraktuale e harmonizuar me pjesëmarrësit e tregut;

i) ndërfaqet e të dhënave.

Neni 50
Detyra të përgjithshme

OST-të përkatëse do të përdorin platformën rajonale të alokimit, të paktën, për qëllimet e mëposhtme:

a) Regjistrimin e pjesëmarrësve në treg;

b) Ofrimi i një pike të vetme kontakti për pjesëmarrësit e tregut;

c) Funksionimin e procedurave të ankandit;

d) Shlyerjen financiare të të drejtave të alokuara të transmetimit afatgjatë me pjesëmarrësit e tregut, duke përfshirë menaxhimin e kolateralëve;

e) Bashkëpunimin me një zyrë kleringu, nëse kërkohet nga rregullat e përbashkëta për zbatimin e FTR-ve- detyrimet sipas nenit 34;

f) Organizimi i një procedure alternative në përputhje me nenin 42 dhe 46;

g) Duke mundësuar kthimin e të drejtave afatgjata të transmetimit në përputhje me nenin 43;

h) Lehtësimin e transferimit të të drejtave afatgjata të transmetimit në përputhje me nenin 44;

i) Publikimi i informacionit të tregut sipas nenit 47;

j) Ofrimin dhe funksionimin e ndërfaqeve për shkëmbimin e të dhënave me pjesëmarrësit e tregut.

KAPITULLI 5
RREGULLAT E HARMONIZUARA TË ALOKIMIT

Neni 51
Rregullat e harmonizuara të alokimit

1. Brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të gjitha OST-të duhet të aplikojnë rregulla të harmonizuara të alokimit për të drejtat afatgjata të transmetimit, në përputhje me nenin 52(2) të rregullores (BE) 2016/1719

2. Pasi kërkesat rajonale të kenë hyrë në fuqi, ato do të prevalojnë mbi kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në rregullat e harmonizuara të alokimit. Në rast se kërkesat e përgjithshme të rregullave të harmonizuara të alokimit ndryshohen dhe i nënshtrohen miratimit të të gjitha autoriteteve rregullatore, kërkesat rajonale do t'i nënshtrohen, gjithashtu, miratimit të autoriteteve rregullatore për rajonin përkatës të llogaritjes së kapacitetit.

Neni 52
Kërkesat për rregullat e harmonizuara të alokimit

Me përjashtim të interkoneksioneve me vendet e treta, rregullat e harmonizuara të alokimit për të drejtat e transmetimit afatgjatë nuk mund të devijojnë nga neni 52^3 të Rregullores (BE) 2015/1222.

KAPITULLI 6
PAQËNDRUESHMËRIA E KAPACITETIT TË ALOKUAR NDËRZONAL

Neni 53
Dispozitat e përgjithshme të pandryshueshmërisë

1. Të gjitha OST-të do të kenë të drejtë të kufizojnë të drejtat afatgjata të transmetimit për të siguruar që operimi të mbetet brenda kufijve të sigurisë operacionale përpara afatit të qëndrueshmërisë së ditës në avancë. Kur OST-të kufizojnë të drejtat afatgjata të transmetimit, ato duhet ta raportojnë këtë tek autoritetet rregullatore përkatëse dhe, gjithashtu, të publikojnë arsyet faktike që çojnë në kufizim.

2. OST-të përkatëse në kufirin e zonës se ofertimit ku të drejtat afatgjata të transmetimit janë kufizuar do të kompensojë mbajtësit e të drejtave të kufizuara afatgjata të transmetimit me përhapjen e tregut.

Neni 54
Përkufizimi i kufirit të kompensimit

1. OST-të përkatëse në kufirin e zonës së ofertimit mund të propozojnë një kufi mbi kompensimin total që duhet t'u paguhet të gjithë mbajtësve të të drejtave të transmetimit afatgjata të kufizuara, në vitin përkatës kalendarik ose muajin kalendarik përkatës në rastin e interkoneksioneve të rrymës se vazhduar (DC).

2. Kufiri nuk duhet të jetë më i ulët se shuma totale e të ardhurave të kongjestionit të mbledhura nga OST-të përkatëse në kufirin e zonës ofertuese në vitin përkatës kalendarik. Në rastin e interkoneksioneve të rrymës se vazhduar (DC), OST-të mund të propozojnë një kufi jo më të ulët se të ardhurat totale të kongjestionit të mbledhura nga OST-të përkatëse në kufirin e zonës ofertuese në muajin kalendarik përkatës.

3. Në rastin e disa interkoneksioneve të operuar nga OST të ndryshme në të njëjtën kufi të zonës se ofertimit dhe që u nënshtrohen regjimeve të ndryshme rregullatore të mbikëqyrura nga autoritetet rregullatore, të ardhurat totale të kogjestionit të përdorura për llogaritjen e kompensimit të kufizuar në përputhje me paragrafin 2 mund të ndahen midis secilit interkonektori. Një ndarje e tillë do të propozohet nga OST-të përkatëse dhe do të miratohet nga autoritetet rregullatore kompetente.

Neni 55
Rregullat e kompensimit

Kur OST-të propozojnë të zbatojnë një kufi të përmendur në nenin 54, ato së bashku do të propozojnë një sërë rregullash kompensimi, në lidhje me kufirin e aplikuar.

Neni 56
Pandryshueshmëria në rast të forcës madhore

1. Në rast të forcës madhore, OST-të mund të kufizojnë të drejtat afatgjata të transmetimit. Një kufizim i tillë do të ndërmerret në një mënyrë të koordinuar pas ndërlidhjes me të gjitha OST-të e prekura drejtpërdrejt.

2. OST që thërret forcën madhore do të publikojë një njoftim që përshkruan natyrën e forcës madhore dhe kohëzgjatjen e mundshme të saj.

3. Në rast të kufizimit për shkak të forcës madhore, mbajtësit përkatës të të drejtave afatgjata të transmetimit do të marrin kompensim për periudhën forcës madhore nga OST-ja që ka thirrur forcën madhore. Në këtë rast, kompensimi do të jetë i barabartë me shumën e paguar fillimisht për të drejtën përkatëse të transmetimit afatgjatë gjatë procesit të alokimit të ardhshëm.

4. OST-ja që thërret një forcë madhore do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të kufizuar pasojat dhe kohëzgjatjen e forcës madhore.

5. Kur Pala Kontraktuese ose shteti anëtar e ka siguruar këtë, me kërkesë të OST-së në fjalë, autoriteti kombëtar rregullator do të vlerësojë nëse një ngjarje kualifikohet si forcë madhore.

KAPITULLI 7
SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE NGA KONGJESTIONI

NENI 57
METODOLOGJIA E SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE NGA KONGJESTIONI

KAPITULLI 8
RIKUPERIMI I KOSTOS

Neni 58

Dispozita e përgjithshme për mbulimin e kostos

1. Kostot e shkaktuara nga OST-të që rrjedhin nga detyrimet në këtë rregullore do të vlerësohen nga të gjitha autoritetet rregullatore.

2. Kostot e vlerësuara si të arsyeshme, efikase dhe proporcionale do të mbulohen në kohën e duhur nëpërmjet tarifave të rrjetit ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm, siç përcaktohet nga autoritetet rregullatore kompetente.

3. Nëse kërkohet nga autoritetet rregullatore, OST-të përkatëse, brenda tre muajve nga kërkesa, ofrojnë informacionin e nevojshëm për të lehtësuar vlerësimin e kostove të bëra.

Neni 59

Kostoja e krijimit, zhvillimit dhe funksionimit të platformës së vetme të alokimit

Të gjitha OST-të që lëshojnë të drejta transmetimi afatgjatë në platformën e vetme të alokimit do të përballojë së bashku kostot që lidhen me krijimin dhe funksionimin e platformës së vetme të alokimit. Brenda gjashtë muajve nga skadimi i afatit për transpozim të kësaj rregulloreje, të gjitha OST-të do të propozojnë një metodologji për ndarjen e këtyre kostove, e cila do të jetë e arsyeshme, efikase dhe proporcionale, për shembull në bazë të parimeve të ngjashme me ato të parashikuara në nenin 80 të rregullores (BE) nr. 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 60

Kostoja e krijimit dhe funksionimit të procesit të koordinuar të llogaritjes së kapaciteteve

1. Çdo OST do të përballojë individualisht kostot që lidhen me sigurimin e inputeve në llogaritjen e kapacitetit.

2. Të gjitha OST-të do të përballojnë së bashku kostot që lidhen me krijimin dhe funksionimin e bashkimit të modeleve individuale të rrjetit.

3. Të gjitha OST-të në çdo rajon të llogaritjes së kapacitetit do të përballojnë kostot e krijimit dhe funksionimit të llogaritësve të koordinuar të kapacitetit.

Neni 61

Kostoja e sigurimit të pandryshueshmërisë dhe kompensimit të të drejtave afatgjata të transmetimit

1. Kostoja e sigurimit të pandryshueshmërisë do të përfshijë kostot e shkaktuara nga mekanizmat e kompensimit, që lidhen me sigurimin e pandryshueshmërisë së kapaciteteve ndërzonale, si dhe koston e rishpërndarjes, tregtimit me kah të kundërt dhe çekuilibrit të lidhur me pjesëmarrësit kompensues të tregut dhe të përballohen nga OST, për aq sa është e mundur, në përputhje me nenin 16(6)(a) i rregullores (EC) nr. 714/2009, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2011/02/MC-EnC.

2. Kur cakton ose miraton tarifat e transmetimit ose mekanizmat e tjerë të përshtatshëm në përputhje me nenin 37(1)(a) të direktivës 2009/72/KE, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2011/02/MC-EnC, dhe duke pasur parasysh nenin 14(1) të Rregullores (KE) nr. 714/2009, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit

Ministror 2011/02/MC-EnC, autoritetet rregullatore do të konsiderojnë pagesat e kompensimit si kosto të pranueshme, me kusht që ato të jenë të arsyeshme, efikase dhe proporcionale.

TITULLI III
DELEGIMI I DETYRAVE DHE MONITORIMI

Neni 62
Delegimi i detyrave

1. Një OST mund të delegojë të gjithë ose një pjesë të çdo detyre, që i është caktuar sipas kësaj Rregulloreje një ose më shumë palëve të treta në rast se pala e tretë mund të kryejë funksionin përkatës të paktën në mënyrë efektive si OST deleguese. OST-ja deleguese do të mbetet përgjegjëse për sigurimin e pajtueshmërisë me detyrimet sipas kësaj Rregulloreje, duke përfshirë sigurimin e aksesit në informacionin e nevojshëm për monitorimin nga autoriteti rregullator.

2. Përpara delegimit, pala e tretë e interesuar duhet t'i ketë demonstruar qartë OST-së deleguese aftësinë e saj për të përmbushur secilin prej detyrimeve të kësaj rregulloreje.

3. Në rast se e gjithë ose një pjesë e ndonjë detyre të specifikuar në këtë rregullore i delegohet një pale të tretë, OST deleguese do të sigurojë që marrëveshjet e përshtatshme të konfidencialitetit në përputhje me detyrimet e konfidencialitetit të OST-së deleguese janë vendosur përpara delegimit.

Neni 63
Monitorimi

1. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të monitorojë zbatimin e alokimit të kapaciteteve afatgjata dhe krijimin e një platforme të vetme të alokimit, në përputhje me këtë Rregullore. Monitorimi do të mbulojë veçanërisht çështjet e mëposhtme

a) progresin dhe problemet e mundshme me zbatimin e alokimit të kapaciteteve afatgjata, duke përfshirë aksesin e drejtë dhe transparent për pjesëmarrësit e tregut në të drejtat afatgjata të transmetimit;

b) efektivitetin e metodologjive për ndarjen e kapaciteteve afatgjata ndërzonalë, në përputhje me nenin 16;

c) raportin për llogaritjen dhe alokimin e kapaciteteve në përputhje me nenin 26;

d) efektivitetin e funksionimit të alokimit të kapaciteteve afatgjata dhe platformës së vetme të alokimit.

2. ...

3. ...

4. Pjesëmarrësit e tregut dhe organizatat e tjera përkatëse, në lidhje me alokimin e kapaciteteve afatgjata, me kërkesë të përbashkët të ENTSO-s për Energjinë Elektrike dhe Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rastet që Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, dorëzojnë në Sekretariat informacionin e kërkuar

për monitorim në përputhje me paragrafin 1, përveç informacionit të marrë tashmë nga autoritetet rregullatore, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë

Neni 64

Dispozitat përfundimtare

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Enti Rregullator i Energjisë.